



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

## Integrimi i edukimit për qëndrueshmëri në klasa

### Qëllimi i programit:

Trajnimi "Integrimi për qëndrueshmëri në klasa" është trajnim i ofruar në formë online. Trajnimi është zhvilluar me mbështetjen e Ambasadës së SHBA-së në Prishtinë. Gjatë vitit 2019-20 ekipi i përbashkët ka punuar në Arizona të SHBA dhe në formën online.

Përmbajtja online është përgatitur nga profesor të Arizona State University (Dr. Lee Hartëell, Dr. Annie Hale dhe Dr. Leanna Archambault) dhe Universitetit të Prishtinës (Prof. Zeqir Veselaj dhe Dr. Blerta Perolli-Shehu). Mbështetje speciale për trajnimin ka dhënë Prof. Lee Hartëell, fitues i Cmimit Nobel për shkencë (2001), i cili ishte edhe ideatori i trajnimit origjinal në SHBA. E njëjta përmbajtje online ofrohet edhe për mësimdhënësit në SHBA nga ASU Biodesign Pathfinder Institute.

Gjatë projektit janë përgatitur videoincizime të reja për kursin, si dhe janë adaptuar materialet e shkruara, situatat e reja nga Kosova, standardet mësimore dhe rezultatet për kushtet e sistemit arsimor në Kosovë dhe kërkesave të Kurrikulës së Kosovës. Videot e përgatitura në platformën Vistia janë shkarkuar në kanalin YouTube të Universitetit të Prishtinës

Para lansimit, përmbajtja i është nënshtruar Betatestimit nga ana e 6 mësimdhënësve të angazhuar nga projekti të cilët kanë vlerësuar se e është conform kërkesave të kornizës për zhvillim profesional të mësimdhënësve në Kosovë.

### Grupi i synuar i mësimdhënësve /vijuesve :

Kurrikula e Kosovës promovon qasjen e mësimdhënies së integruar në tërë përmbajtjen e saj. Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm është e listuar si njëra nga çështje ndërkurrikulare në të gjitha fushat kurrikulare dhe e cila fare mirë integrohet në fushat lëndore si: gjuha dhe komunikimi, matematika, artet, shkencat e natyrës, shkencat shoqërore etj.

Ky kurs online synon integrimin e çështjeve të qëndrueshmërisë në fushat kurrikulare dhe lëndët mësimore duke filluar që nga fëmijëria e hershme e deri në përfundim të sistemit parauniversitar të arsimit (K-12). Pranda trajnim synon mësimdhënës nga këto fusha:

- Edukatore të fëmijërisë së hershme (kopshteve dhe çerdheve)
- Mësimdhënës të ciklit fillor (që mbajnë të gjitha lëndët),
- Mësimdhënës lëndor të fushave: gjuhë e komunikimi, arte, matematikë, shkenca natyrore, shkenca shoqërore.

### Rezultatet e programit :

Pas përfundimit të trajnimit, vijuesit do të jenë në gjendje të:

- definojnë dhe shpjegojnë konceptet kyçe të zhvillimit të qëndrueshëm dhe edukimit për zhvillimin e qëndrueshëm në kurrikulën zyrtare;
- aplikojnë qasjen e 4 Mënyrave të të Menduarit (Four Ways of Thinking): të menduarit për të ardhmen, të menduarit strategjik, të menduarit sistematik dhe të menduarit në vlera;
- përgatisin aktivitete mësimore bazuar në katër mënyrat e të menduarit dhe të menduarit me standarde;
- integrojnë tema të caktuara nga lista e "100 temave të qëndrueshmërisë" në planprogramet e tyre mësimore;
- dizajnojnë aktivitete mësimore me qasje të integruar ku qëndrueshmëria integrohet në lëndët e tyre respektive gjatë mësimin.